

VENDIM

Nr. 240 datë 13.4.2001

PER NDARJEN E TE ARDHURAVE, QE RRJEDHIN NGA USHTRIMI I VEPRIMTARISE NGA SUBJEKTET E LICENSUARA PER LOJRA FATI, KAZINO DHE HIPODROME

Në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës dhe të neneve 10, 22 dhe 25, të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000, "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndarja e të ardhurave për organizatorin dhe fituesit nga lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet, behet pasi nga totali i qarkullimit të realizuar, te zbriten më parë tatimi mbi vlerën e shtuar dhe tatimi mbi lojërat e fatit.

Tatimi mbi vlerën e shtuar llogaritet duke pjesëtuar "qarkullimin gjithsej", (të ardhurat) me shifrën 6. Pjesa që mbetet pas zbritjes së tatimit mbi vlerën e shtuar përbën "qarkullimin" (të ardhurat pa tatimin mbi vlerën e shtuar).

Tatimi mbi lojërat e fatit, llogaritet duke pjesëtuar "qarkullimin" (të ardhurat pa tatimin mbi vlerën e shtuar) me shifrën 6. Pjesa që mbetet pas zbritjes së tatimit mbi lojërat e fatit, ndahet ndërmjet organizatorit dhe fituesit.

2. Ndarja e të ardhurave nga lojërat e fatit, pasi më parë janë zbritur detyrimet tatimore (tatimi mbi vlerën e shtuar dhe tatimi mbi lojërat e fatit), sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet si vijon:

Për lojërat aritmetike:

60 për qind e të ardhurave që mbeten, i jepen fituesit/fituesve të lojës;

40 për qind e të ardhurave që mbeten, i merr organizatori i lojës, pra subjekti i licencuar.

Për lojërat sportive:

60 për qind e të ardhurave që mbeten, i jepen fituesit/fituesve të lojës;

40 për qind e të ardhurave që mbeten, i merr organizatori i lojës. Një pjesë e të ardhurave të organizatorit shkon në favor të fondit kombëtar të zhvillimit të sportit, në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas propozimit të ministrit përkatës, dhe duke u përcaktuar në lejen që i jepet organizatorit.

Për lotaritë:

60 për qind e të ardhurave që mbeten, i jepen fituesit/fituesve të lojës;

40 për qind e të ardhurave që mbeten, i merr organizatori i lojës.

Për lojërat elektronike:

50 për qind e të ardhurave që mbeten, i jepen fituesit/fituesve të lojës;

50 për qind e të ardhurave që mbeten, i merr organizatori i lojës.

Ndarja e të ardhurave për lojërat e fatit, që organizohen nga Kryqi i Kuq Shqiptar, pasi më parë janë zbritur detyrimet tatimore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet si vijon:

50 për qind e të ardhurave që mbeten, i jepen fituesit/fituesve të lojës;

50 për qind e të ardhurave që mbeten, i merr organizatori i lojës.

3. Ndarja e të ardhurave nga kazinotë, pasi më parë janë zbritur detyrimet tatimore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet si vijon:

60 për qind e të ardhurave që mbeten, i jepen fituesit për çdo lojë në kazino;

40 për qind e të ardhurave që mbeten, i merr organizatori, subjekt i licencuar për ushtrimin e veprimtarisë në kazino.

4. Ndarja e të ardhurave nga hipodromet, pasi më parë janë zbritur detyrimet tatimore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet si vijon:

60 për qind e të ardhurave që mbeten, i jepen fituesit për çdo lojë në hipodrom;

40 për qind e të ardhurave që mbeten, i merr organizatori, subjekt i licencuar për ushtrimin e veprimtarisë në hipodrom.

5. në rastet e parashikuara në pikën 5, të nenit 13 dhe në pikën 6, të nenit 23, të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000, për organizatorin e lojës detyrimet për të ardhurat e realizuara do të jenë të njëjta me atë të përcaktuar për organizatorët e tjerë, që kanë si objekt veprimtarie ushtrimin e lojërave elektronike, të fatit, me fitim në çast.

6. Këshilli i Ministrave ka autoritetin dhe mund të rishikojë raportin e ndarjes së të ardhurave, ndërmjet organizatorit dhe fituesit për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

ILIR META